

Mirela PAPA
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Universiteti i Tiranës
Tiranë, SHQIPËRI
E-mail: papamirela@yahoo.com

TË PËRKTHESH PASTHIRRMAT E PROZËS PIRANDELIANE TRANSLATING THE INTERJECTIONS IN PIRANDELLO'S FICTION

1. Hyrje

Studimi i pasthirmave nga ana e gramaticienëve dhe leksikografëve nuk ka qenë kurrë aq i thellë sa studimi i bërë për elementët e tjerë të fjalisë. Nga njëra anë ngurrimi nëse duhen përfshirë apo jo në kategoritë e tjera të ligjëratës, nga ana tjetër përkufizimet e pakta që janë bërë lidhur me to kanë sjellë që njohja që kemi për pasthirmat të jetë e pamjaftueshme dhe vështirësitë që ndonjëherë ndeshim për interpretimin e tyre vijnë si pasojë e mungesës së vëmendjes së fjalorëve karshi kësaj klase elementësh.

Në këtë artikull do të paraqesim një studim të pasthirmave që Pirandelo përdor në tregimet e tij dhe mënyrën se si këto pasthirmat janë përkthyer në gjuhën shqipe. Do të shikojmë nëse përkthyesit kanë arritur të japin edhe në gjuhën tonë kuptimin e këtyre pasthirmave që herë-herë nuk shërbejnë për të filluar bisedën, por ndikojnë tek kjo e fundit duke nxjerrë në pah ndjeshmërinë e fjalëve të caktuara.

2. Qasje teorike

Mungesa e një studimi të veçantë për pasthirmat në gjuhën italiane e ka çuar Leo Spitzer-in t'i përkufizojë si elemente leksikore të një

gjuhe, me kuptime konvencionale dhe tradicionale. Ato kanë vlerën e një komunikimi të tërë që është thujtë gjithmonë shprehje e një gjendjeje shpirtërore subjektive (Spitzer 1922).

Spitzer trajton disa nga aspektet e pasthirmave që lidhen me etimologjinë, huazimin etj. Është me interes vërejtja që ai bën sipas së cilës pasthirrat nuk shërbejnë vetëm për të filluar bisedën; ndonjëherë ndikojnë tek ajo. Lind, pra, një problem i vështirë për t'u zgjidhur: kuptimi i pasthirmave. Nëse nga njëra anë mund të pohojmë se pasthirrat vuajnë nga mungesa e një përmbajtjeje semantike të vetën falë përcjelljes së përmbajtjes konotative të fjalisë, nga ana tjetër ekzistojnë raste të tjera në të cilat saktësia semantike është e fiksuar dhe nuk mund të kalojë te pasthirra të tjera.

Njëzet vjet më vonë Karcevski do të sjellë kontributin e tij lidhur me problematikën e pasthirmave. Studimi kishte si qëllim përfshirjen e pasthirmave në teorinë sosyriane dhe strukturaliste të shenjës. Ai dallon dy lloje mes tyre: *onomatopenë* dhe *pasthirmën*. Ndiheja që solli studimi i Karcevski-t konsiston në faktin se futi intonacionin në përkufizimin e fjalisë.

3. Karakteristika të stilit pirandelian

Sipas Nencioni-t, “motorët e sintaksës pirandeliane janë copëzimi, inversioni dhe variacioni, shpesh të provokuara nga elementa të posaçëm si pasthirrat, thirrjet dhe të favorizuara nga një shtjellim i pasur i deisit; të gjithë këta faktorë që, nga ana e tyre, bëjnë pjesë të luhajta e tonit dhe të gjestualiteti i intensifikuar” (Nencioni 1977: 229).

Duhet të shtojmë se dy elementët e parë copëzimi dhe inversioni janë të dyfishtë, domethënë janë sintaksorë dhe melodikë, gjë që na shpie te problemi i ndërveprimit mes planeve sintaksore dhe semiotike të të folurit.

Në këtë kuptim mund të pohojmë se sintaksa dhe ndryshimi i tonit nuk përputhen gjithmonë, duke qenë se ky i fundit mund të ndryshojë ndërkohë që ruhet e para. Në këtë rast mbase mund të flitet për njëfarë epërsie të melodisë mbi elementin sintaksor, të muzikës mbi gramatikën. (Me këtë problem është marrë kryesisht Sergio Karcevski dhe Charles Bally. I pari shkroi *Sur la phonologie de la phrase*, në TCLP, IV, 1931; *A Prague School Reader in Linguistics*, Indiana University Press, Bloomington-London, 1967; dhe *Introduction à l'étude de l'interjection*, në “Cahiers F.de Saussure”, I. 1941. Bally shkroi, *Traité de stylistique française*, Paris-Ginevra, 1951, I; dhe *Linguistique générale et linguistique française*, Bernë 1944.)

Te Pirandelo vëmë re se në dialogët e tregimeve të tij vija melodike ka të njëjtën rëndësi si vija sintaksore, duke arritur madje edhe ta kapërcejë dhe ta kushtëzojë këtë të fundit.

Në veprën e Pirandelos pasthirrma ndihmon për t'i dhënë ekspressivitet prozës së natyrshme dhe spontane të gjuhës italiane të asaj epoke. Në këtë kuptim ajo vepron si një valvolë shkarkimi për emotivitetin e pamenduar dhe të pashprehur. Kështu, pra, mund ta konsiderojmë si fjalë shprehëse të mirëfilltë së bashku me lokucionet thirrrore, betimet, mallkimet, fyerjet, onomatopetë dhe të tjera lokucione shprehëse.

4. Pasthirrmat e prozës pirandeliane dhe përkthimi i tyre

Një konstatim i parë i referohet shpeshtësisë së përdorimit: faqet e tregimeve dhe novelave pirandeliane janë të mbushura me pasthirrma, thirrrore, fjali të ndërkalura, domethënë, të gjithë ata elementë që kanë një forcë të madhe “tonike”, shenjë kjo siç e kemi thënë edhe më lart e një mënyre të shkruari e drejtuar nga gjuha e folur.

Të gjithë pasthirrmat që kemi ndeshur në tregimet e Pirandelos i përkasin tipologjisë konvencionale të gjuhës italiane. Mbizotërojnë ato të llojit *ah*, *eh*, *oh*; nuk është i shpeshtë përdorimi i *mah*, *uh*; janë të kufizuara përdorimi i *ohè*, *ohi*, *ih*.

Deri tani është studiuar pasthirrma (e shkruar) në vetvete, ndaj me qëllim që të përcaktojmë vlerën e saj nuk kemi mundur të shmangim përpjekjen për të bërë perifrazimin. Këto fakte evidentojnë nga njëra anë vlerën e paktë semantike të pasthirmës, dhe nga ana tjetër shpeshtësinë e përdorimit të saj”, prandaj perifraza rezulton ndonjëherë shumë e gjerë dhe e vështirë. Kushtëzimi sintagmatik, ndonëse zë një aspekt pasiv te pasthirrma, nuk përjashton edhe një aspekt aktiv, domethënë të veprimit mbi sintaksën. Këtij aspekti të fundit i kemi kushtuar edhe vëmendjen tonë.

Pasthirrmat kur hapin dialogun jo vetëm paraprijnë ligjëratën e afërt, por kanë edhe efekt tek ajo, përderisa folësi, duke shkarkuar mbi të përmbajtjen e gjendjes së tij shpirtërore te momentit, informon nga ana e tij bashkëbiseduesin dhe e orienton drejt përmbajtjes konotative të asaj që do të shprehë. E njëjta gjë mund të thuhet për pasthirmën që ndeshet në brendësi të ligjëratës, ku forca e tonit tërheq vëmendjen e bashkëbiseduesit.

4.1. Pasthirrma AH!

Është pasthirmë shumë e përdorur dhe me kuptime të ndryshme. Shpreh, sipas rasteve dhe intonacioneve të zërit, ndjenja apo gjendje

shpirtërore të ndryshme si: çudi, gëzim, lehtësim, dhimbje, kërcënim, kënaqësi, zemërim (...) (Zingarelli 2002)

Të ilustruara me shembuj disa nga këto vlera:

4.1.1. *Për të tërhequr vëmendjen e bashkëbiseduesit:*

- E si va piano, sempre di passo. Ah, non c'è pericolo che tu sudi e ti strofinino al ritorno.

Dhe ecet ngadalë, gjithë me hap të matur. Nuk ka rrezik të djersitesh e të të fërkojnë kur të kthehesh; karrocieri nuk të qëllon kurrë me kamxhik e as të gudulis me gjësend tjetër. (Pirandello 1997: 140).

Në këtë rast pasthirrma nuk është përkthyer. Mund të ishte përdorur pasthirrma *a* në gjuhën shqipe që përdoret kur kujtohem për diçka gjatë bisedës me dikë apo kur i drejtohem një njeriu zakonisht të afërt a të njohur.

4.1.2. *Befasi, çudi, zhgënjim*

- Ah, - fece quella, alzando il capo a guardare la tabela sul porticino. - Stai proprio dentro la scuola?

- Oh, - ia bëri tjetra, duke ngritur për të parë tabelën te porta. - Banoke brenda shkollës? (Pirandello 1999: 125).

- Ah! - esclamò allora il Gori, ralleggrandosi improvvisamente. - Le nozze dunque si faranno lo stesso?

- Ah! - thirri atëherë Gori, duke u gëzuar përnjëherësh. - Domethënë martesë do të bëhet gjithsesi? (Pirandello, *Nata e parë* 2008: 173).

Në rastin e parë pasthirrma është përkthyer me pasthirmën *oh*, pasthirmë e cila në gjuhën shqipe përdoret për të shprehur habi, tronditje, frikë etj. Në rastin e dytë është përkthyer me pasthirmën *ah* e cila gjithashtu përdoret për të shprehur zemërim, kërcënim apo habi, frikë etj.

4.1.3. *Mosmiratim*

- Ah, non la poteva bere, lui, quell'acqua greve, cruda, renosiccia delle cisterne.

Medet: ai nuk mund ta pinte atë ujë të rëndë, të pashije dhe të ndenjtur të hauzeve. (Pirandello, *Nata e parë* 2008: 144).

Në këtë rast pasthirrma *ah* është përkthyer me pasthirmën e gjuhës shqipe *medet*. Kjo pasthirmë në shqipe shpreh dëshpërim, dhembje, keqardhje, frikë. Për të respektuar ngjyrimin që përcjell kjo pasthirmë në veprën origjinale mund të ishte përkthyer me pasthirmën *ah* të gjuhës shqipe e gjithashtu përdoret për të theksuar shprehjen e kundërshtimit, të mospranimit.

4.1.4. *Vrarje ndërgjegjeje, pendim:*

- (...) ripensando - ah! - alle ultime parole del compare - ah! gli pareva di vederselo ancora lì, nella bottega, nell'atto di tentennare amaramente il capo, - ah! ah! ah!

...tek sillte ndër mend ato fjalët e fundit të kumbarës... I dukej sikur i dilte përsëri para syve, aty në dyqan, duke shkundur lehtazi kokën. (Pirandello 2010: 96).

Në rastin e mësipërm pasthirrma nuk është përkthyer në tekstin në gjuhën shqipe.

4.1.5. *Inat, urrejtje, dëshirën për hakmarrje:*

- Ah, vile, vile quell'uomo che gliel'aveva inflitta, abandonandola, dopo averla svergognata!

Ah, sa i poshtër paska qenë ai burrë që i shkaktoi tërë këtë vuajtje dhe e braktisi pasi e turpëroi! (Pirandello 1997: 63).

Ka raste kur pasthirrma mund të mbështetet nga elementë të tjerë të fjalisë:

- Ah Dio mio, Dio mio! è così! Di', ne hai notizie, tu?

- O Zot, o Zot! Kështu, ë? Po më thuaj, a ke lajme prej tij? (Pirandello 1999: 126).

- Ah Fofò, non ne posso proprio più!

"Më sheh, o Fofò? Po mbahem me shpirt ndër dhëmbë." (Pirandello 1997: 141).

Në dy rastet e mësipërme pasthirrma nuk është përkthyer. Është përdorur o që në këto kontekste ka vlerën e një pjesëze që përdoret për të përforcuar thirrjen kur i drejtohem dikujt (me emra në funksion thirrori). Ndërsa pasthirrma o në gjuhën shqipe shërben për të shprehur dhimbje ose keqardhje për dikë apo për diçka, apo habi, gëzim, kënaqësi a admirim për diçka.

- Me la fai vedere? – ripeté l'altra, come se non avesse inteso. – Ah, già, perché tu fai qua la maestra. Già!

- Do të ma tregosh, - përsëriti tjetra, sikur të mos e kishte mbajtur vesh. – Ah, po, se ti këtu je mësuese. Si s'u kujtova? (Pirandello 1999: 124).

4.1.6. *Dhimbje:*

- Ah mamma, muojo! Quanto soffro, mamma mia, quanto soffro!

- Nëno, po vdes! Sa po vuaj, nëna ime, sa jam duke vuajtur! (Pirandello, *Zoja prej dylli* 2008: 117).

Në rastin e mësipërm nuk është përkthyer pasthirrma në novelën e përkthyer.

4.2. Pasthirrma EH!

Është ndoshta më e përdorura pas AH. Shpreh pakënaqësi, ngurrim, keqardhje me ngjyrimë të ndryshme që shkojnë nga indinjata, (zemërimi) te qortimi, kërcënimi, mosaprovimi, dhembshuria, këshillimi (nxitja), nënshtrimi (durimi).

4.2.1. *Siguri, konstatim:*

- (...) Vedi, t'ha fatto male? Eh, ne avrai di molte tu oggi, te lo dico io.

...Të dhembti? Hej, sa herë kanë për të ta shtrënguar frerin sot, të thashë unë. (Pirandello 1997: 143).

Në këtë rast pasthirrma është përkthyer me pasthirmën *hey* e cila në gjuhën shqipe përdoret si thirrje për të shprehur kënaqësi, habi, hidhërim, keqardhje a ndonjë ndjenjë tjetër. Mund të ishte përkthyer fare mirë me pasthirmën *eh* e cila shpreh dhembje, hidhërim, pikëllim, keqardhje, pendim, habi, frikë, kërcënim, zemërim etj.

4.2.2. Konstatim i hidhur:

- La mia casa? – fece con un sorriso impacciato la maestrina Boccarmé. – Eh, io non ne ho.

- Shtëpinë time? – tha mësuesja Bokarme duke buzëqeshur me zor. – Eh, s’kam shtëpi. (Pirandello 1999: 124).

- Lo hai amato, di’ la verità. Eh, lo vedo, poverina. Fu forse tuo fidanzato? E ke dashur? Thuajmë të vërtetën. E shoh, e shoh, e shkreta ti mos keni qenë gjë të fejuar? (Pirandello 1999: 126).

Në rastin e mësipërm pasthirrma nuk është përkthyer.

4.2.3. Nënshtrim, dorëzim:

- Eh, troppo tardi, carina! – esclamò la Valpieri, con un gesto sguajato.

- Eh, ishte tepër vonë, e dashur! – thirri Valpieri, duke bërë një gjest trashanik. (Pirandello 1999: 126).

4.2.4. Ngurrim, dyshim:

- Ma come? Dorme ancora? – Eh, - fa il cameriere, alzando le spalle, - si vede che sarò stanco... Ha viaggiato tanto!

- Si thua? Ende fle?

- Ç’i bësh! – thotë kamerieri duke ngritur shpatullat, - duket se është lodhur... Ka udhëtuar aq shumë! (Pirandello 1997: 135).

Në rastin e mësipërm pasthirrma nuk është përkthyer.

Pasthirrma *eh* gjithashtu është përdorur shpeshherë bashkë me fjalë të tjera me vlerë të madhe intonative, ndonëse semantikisht e përcaktuar dhe e orientuar, si për shembull sì, già:

- Eh, già! – fece Bobbio a questo punto, accentuando il risolino. – Eh, già!

- Posi jo! – thirri Bobio, kur mbërriti tek ato fjalë, duke buzëqeshur me më shumë skepticizëm. – Posi jo! (Pirandello, *Nata e parë* 2008: 131).

- Gli venne da sbruffare; si trattenne a tempo, e sospirò, come uno stupido: - Eh già... Povera figliuola!

E përmbajti veten në kohë dhe psherëtiu si sherr budallai. - Ç’i bësh, e gjora çupë! (Pirandello, *Nata e parë* 2008: 174).

Në dy rastet e mësipërme pasthirrma nuk është përkthyer. Kuptimi semantik i origjinalit është përcjellë gjithsesi edhe në tekstin e përkthyer me përdorimin e mjeteve të tjera të gjuhës. Kështu në rastin e parë është dhënë me pjesëzën *posi*, ndërsa në rastin e dytë me përemrin pyetës *çfarë* në pyetje retorike.

4.3. Pasthirrma OH!

Për nga denduria është e treta ndër pasthirrat më të përdorura. Shpreh, sipas intonacionit me të cilin shqiptohet, dhembshuri, dëshirë, dyshim, habi, mërzi, kënaqësi, druajtje, (...)

4.3.1. Ironi:

- Oh, per gravità, forse ne avevano anche troppa!
- Oh, sa për hije të rëndë, ndofta kishin edhe tepër! (Pirandello 1997: 139).
- Che diavolo contiene quella cassa? Pesa, oh, non credere!
- Ç'djall të ketë brenda ajo arkë? Peshon, ore, sa s'ta ha mendja! (Pirandello 1997: 141).

Në rastin më sipër pasthirrma është përkthyer me pasthirrmën *ore* të gjuhës shqipe e cila përdoret për të shprehur habi, admirim, a ndonjë ndjenjë tjetër.

- Oh, lo dà a tutte, sai, codesto vecchio ritratto. L'ha dato anche a me.
- Oh, ta dish, ua jep të gjithave atë fotografi të vjetër. Ma ka dhënë edhe mua. (Pirandello 1999: 127).
- Oh, guarda, la signora Direttrice!
- Oh! Zonja Drejtoreshë! (Pirandello 1999: 133).

4.3.2. Miratim:

- Oh, brava; dunque ne avrai un poco anche per me!
- Mrekulli: domethënë se do të kesh pak durim edhe për mua. (Pirandello 1999: 125).

Pasthirrma nuk është përkthyer.

4.3.3. Zgjidhje:

- Oh, no, no; egli, nella sciagura che lo aveva atterrato, messo in guerra con tutti e con se stesso, non poteva più fare a meno di quella donna fervida e forte.
- Jo, jo, mes asaj fatkeqësisë që e kishte përgjunjur dhe që e kishte futur në luftë me të gjithë e me vetveten, nuk mund të bënte pa atë grua të gjallë dhe të fortë. (Pirandello, *Zoja prej dylli* 2008: 123).

Pasthirrma nuk është përkthyer.

Janë të shumtë rastet kur pasthirrma *oh* del e shoqëruar me elementë të tjerë të fjalisë për të formuar një njësi të vetme melodike. Më sipër pamë raste të tjera bashkimi, si për shembull me pasthirrma të tjera pak a shumë të semantizuara (ah già!, eh già!, eh via!, eh sì! oh no!) duke formuar binomë që shpeshherë te Pirandello paraqiten të ndarë nga një presje, domethënë të artikuluar në dy njësi melodike. Citojmë disa shembuj të këtij llojit të fundit.

a) Tmerr:

- Oh Signore Iddio! Con la morta in casa? Ooh! - Oooh! - echeggiarono, miagolando, le due zitellone con orrore.
- O Zot i madh, me të vdekurën në shtëpi? O-oh!

- O-o-oh! – jehuan duke mjaullitur të lebetitura dy lëneshat. (Pirandello, *Nata e parë* 2008: 173).

b) Ankesë:

- Oh Dio, se avessi potuto aspettare che tu...

O Zot, sikur të më kishte shkuar mendja se ti... (Pirandello 1999: 128).

Në dy rastet e mësipërme pasthirrma nuk është përkthyer. Është përdorur o që në këto kontekste ka vlerën e një pjesëze që përdoret për të përforcuar thirrjen kur i drejtohem dikujt (me emra në funksion thirrori).

Oh Dio! la marsina... già! La marsina per le nozze, castigata così a comparire ora davanti alla morte. Che fare?

Fraku e pat. Fraku i dasmës qe dënuar të dukej në ksollë. Ç'të bënte? (Pirandello, *Nata e parë* 2008: 171).

Pasthirrma nuk është përkthyer.

4.4. Pasthirrma SU!

Vlera e saj kryesore është nxitëse në fjalitë thirrmore. Me këtë vlerë mbizotëron në tregimet pirandeliane të analizuara në të cilët, shpeshherë, prodhohet përsëritja duke përfutur kështu një ngarkesë më të madhe urdhëruese; gjithashtu mund edhe të shfaqet e shoqëruar me elementë të tjerë si via!, coraggio etj.

- Su, che avete da dirmi?

- E di kush të dërgon, - i tha me zë të ulët Markezi, - Hajde ç'ke për të më thënë? (Pirandello, *Zoja prej dylli* 2008: 118).

- Su, su, via, si alzi, mia cara vecchia signora!

- Hajde, çohu, o zonjë plakë e nderuar! S'është koha për shaka të tilla! (Pirandello, *Nata e parë* 2008: 174).

- Ma tu alzati! Non farmi calare, perché non posso calarmi! Alzati da te! Subito, via! Su, su, fammi il piacere!

Po ti çohu, mos më detyro të ulem se nuk mundem. Çohu vetë! Tani! Hajde, hajde, bëma qejfin. (Pirandello, *Nata e parë* 2008: 175).

- Su, su, non pensiamo a malinconie adesso!

Po tani të mos mendojmë për gjëra të trishtuara. (Pirandello 1999: 125).

- Su, su, andiamo, figliuolo!

Eja, eja të shkojmë, biri im! (Pirandello 1997: 56).

Në të gjitha rastet pasthirrma është përkthyer me pasthirmën e gjuhës shqipe *hajde* e cila përdoret kur thërresim, kur ftojme, kur nxitim dikë për të nisur një punë, për të bërë diçka etj.

Ndalemi pa në dy rastet e fundit. Në rastin e parë pasthirrma nuk është përkthyer, ndërsa në rastin e dytë është përkthyer me një tjetër pasthirmë të gjuhës shqipe *eja* që është sinonim i pasthirmës *hajde*. Nga shembujt e sjellë me sipër vihet re se si nxitja mund të jetë një ftesë me fjalë, vepra, mund të jetë reflektimi i një sjelleje personale etj.

4.5. Pasthirrma UH!

Shpreh sipas tonit me të cilin shqiptohet, dhimbje të fortë, bezdi, habi, befasi, mosaprovim, pakënaqësi apo edhe dëshirë.

4.5.1. *Dhimbje:*

- Titti, ahi!, i miei capelli... Dio, Dio... me li strappi tutti... uh...
- Titi, oj, oj flokët!... Po m'i shkul të gjitha... oj... të gjitha flokët e mamasë, vajzë e keqe! (Pirandello 1997: 192).

Në këtë rast pasthirrma është përkthyer me pasthirmën *oj* e cila në gjuhën shqipe nuk shpreh dhimbje, por frikë drujtje, habi, qesëndi sigurinë e një veprimi, miratimi për një gjendje etj. Më i saktë do kishte qenë përkthimi me pasthirmën *u* e cila përdoret kur shprehim dhembje ose pakënaqësi për diçka të papëlqyeshme.

4.5.2. *Bezdi:*

- Piano, uh... piano! Che ti piglia?
- ...Ngadalë, ej... ngadalë! Ç'pate? E shikon? (Pirandello 1997: 143).

Është përkthyer me pasthirmën *ej* (*hej*) që përdoret si thirrje për të shprehur kënaqësi, habi, hidhërim, keqardhje a ndonjë ndjenjë tjetër. Ose përdoret kur i drejtohem dikujt për ta thirrur, për t'i tërhequr vëmendjen, për ta nxitur etj.

4.5.3. *Habi:*

- Che avviene? – sgridava da ogni parte. – Uh, guarda, s'impegna un cavallo del carro mortuorio!
- Ç'po ndodh kështu? – thërrisnin nga të katër anët. – Uh, vështro, një kalë i karrocës së përmotshme ka ngritur lart këmbët e para! (Pirandello 1997: 143).

4.6. Pasthirrma AHI!

Shpreh thujtë ekskluzivisht dhimbje fizike apo morale.

- Ahi! Maledizione. Diòòdiodio! – Che cos'è? S'è fatto male? – Il piede. Ahiahi! Ma non ci avrebbe un fiammifero, scusi?
- Obobo! E marrtë dreqi! Zot, o Zot, o Zot! – Ç'patët? U vratët? – Këmba! Oj, oj, oj! Më falni po nuk u ndizka dot një shkrepëse? (Pirandello, *Zoja prej dylli* 2008: 84).
- Gli si faceva anzi più forte... Ecco, ahi, ahi... più forte, più forte (...). Possibile? Di nuovo?... Ma che, no! Ahi ahi... ahi ahi...
- Përkundrazi e shtrëngoi edhe më fort... Ja, oh! oh!... Më shumë... më shumë (...) Thua? Prapë?... Jo mor, çne! Oj, oj... Oj, oj... (Pirandello, *Nata e parë* 2008: 132).
- Ahi ahi... ahi ahi... !
- Oj oj... oj oj... (Pirandello, *Zoja prej dylli* 2008: 120).

Vëmë re se në këto raste pasthirrma nuk përkthehet në të njëjtën mënyrë. Brenda të njëjtit kontekst ajo përkthyer me dy pasthirrma të gjuhës shqipe *obobo... oj, oj oj...* dhe *oh, oh ... oj, oj, oj*. Do kishte qenë mirë të ishte përdorur e njëjta pasthirmë, ndonëse të dyja e ruajnë ngjyrimin e fjalisë origjinale.

4.7. Pasthirrma OHE!

Përdoret për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve apo si lajmërim, edhe kërcënues.

- Ohe, la smetti? Bada che mi svegli i piccini.
- Qepe, mor! Do të më zgjosh fëmijët! (Pirandello, *Nata e parë* 2008: 76).
- Ohé! Voi! Vi siete fatta male?
- Oh! Qenkeni ju! U vratë gjë? (Pirandello 2010: 28).

Në rastin e dytë më mirë do të kishte qenë përkthimi me: *ore, hej* sepse *oh* nuk shërben në gjuhën shqipe për të tërhequr vëmendjen e të tjerëve.

4.8. Pasthirrma MAH!

Shpreh dyshim, pasiguri në përgjigje. Varianti grafik i MA. H-ja që vendoset pas saj i përgjigjet ose një frymëmarrjeje ose një ngritjeje të tonit apo të dy gjërave.

- Che sono i discorsi? Mah! Ci capisco poco, dico la verità. Përse mbajnë fjalime? Hëm! Pak marr vesh, të them të drejtën. (Pirandello 1997: 142).

4.9. Pasthirrma VAH!

Varianti grafik i pasthirmës VA. Shpreh habi, çudi, (...)

- E che sai tu di Dio, verme di terra? Quello che te n'hanno detto i preti? Ma Dio... vah, vah, vah, io mi metto a ragionare con te, adesso... Hai fatto colazione?
- E ku di ti se ç'është perëndia, o krimb toke! Atë që të kanë thënë priftërinjtë! Po perëndia... Shko mor tutje: dhe unë që po filloj të diskutoj me ty... Ke ngrenë? (Pirandello, *Nata e parë* 2008: 82).

Është zëvendësuar pasthirrma me një frazeologji në gjuhën shqipe që do të thotë Luaj vendit! Me gjithë mend e ke? Shpreh, pra, habi dhe e përcjell ngjyrimin semantik të origjinalit.

- Che ti fanno vedere codeste lenti? Povero vecchio mio, vah! Zero, via, zero, zero...
- Çfarë të sjellin përpara syve ato syze? I gjori plaku im, eh! Zero hajt zero, zero... (Pirandello, *Formalitet*, Shkëndija, Nr. 2 dhe 3, përkthyesi NeHa.)

Përfundime

Vëmë re, pra, një ndryshim të vijës melodike në tregimet e Pirandelos nëpërmjet përdorimit të pasthirmave. Ndoshta Pirandelo ishte i detyruar ta bënte këtë ndryshim të tonit duke pasur parasysh karakterin bisedimor të tregimeve dhe novelave të tij, të cilat në shumë raste ishin paprijëse të komedive të tij. Kur dialogu është thujse një monolog, duke qenë se personazhi heton brenda vetes dhe i paraqet bashkëbiseduesit rezultatin e eksperiencës së tij të brendshme, atëherë zvogëlohen thyerjet duke zvogëluar kështu edhe shpejtësinë e ligjërimit dhe duke rritur, pa dyshim, atë që Karcevski e quan «intonacion asimetrik», domethënë rezultati i nxjerrjes në pah të njërive të tonit përmes përfshirjes së njërive të tjera më neutrale në vend që të ngrihet në mënyrë të ashpër toni.

Ajo ç'ka thamë deri këtu shërben për të treguar, edhe një herë, rëndësinë e pasthirmës në gjuhën e folur përmes gjuhës së shkruar. Për sa i përket përkthimit të pasthirmave duhet thënë se në shumicën e rasteve janë përkthyer nga përkthyesit duke përcjellë, pra, atë veçanti stilistikore të Pirandelos, ndërsa në disa raste janë lënë pa përkthyer duke bjerrë kështu stilin bisedimor të tregimeve. Si përfundim duhet thënë se përkthimi i pasthirmave në rastin e Pirandelos është jashtëzakonisht i domosdoshëm për të respektuar kështu *intentio-auctoris*.

Bibliografi:

- BORZI I., ARGENZIANO M. (1993), (nën kujdesin e) *Luigi Pirandello* *Novelle per un anno*, Newton&Compton Editori, Roma.
- KARCEVSKI S. (1941), Introduction à l'étude de l'interjection: "*Cahiers de F. de Saussure*".I.
- KOSTALLARI A. (hartues) (1980), *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë.
- LEKA F., SIMONI Z. (2000), *Fjalor italisht-shqip*, Infbotues, Tiranë.
- NENCIONI G. (1977), *L'interiezione nel dialogo teatrale di Pirandello*, në *Studi di grammatica italiana*, VI, f. 227-283.
- PIRANDELLO L. (1999), *Tregime e Novela*, Dituria, Tiranë.
- PIRANDELLO L. (2008), *Nata e parë*, Toena, Tiranë.
- PIRANDELLO L. (2008), *Zoja prej dylli*, Toena, Tiranë.
- PIRANDELLO L. (1997), *Novela për një vit. Jeta lakuriq*, Çabej, Tiranë.
- PIRANDELLO L. (2010), *Teze Mikelina*, Toena, Tiranë.
- SPITZER L., (1922), *Italienische Umgangssprache*, Bonn-Leipzig.

TERRACINI B. (), *Considerazioni sullo stile delle novelle di Pirandello*, në *Atti del Congresso Internazionale di Studi Pirandelliani*, f. 729-734.

ZINGARELLI N. (2002), *Vocabolario della lingua italiana*, Zanichelli, Bolonjë.

Përmbledhje

Studimi i pasthirmave nga ana e gramaticienëve dhe leksikografëve nuk ka qenë kurrë aq i thellë sa studimi i bërë për elementët e tjerë të fjalisë. Nga njëra anë ngurrimi nëse duhen përfshirë apo jo në kategoritë e tjera të ligjëratës, nga ana tjetër përkufizimet e pakta që janë bërë lidhur me to kanë sjellë që njohja që kemi për pasthirrat të jetë e pamjaftueshme dhe vështirësitë që ndonjëherë ndeshim për interpretimin e tyre vijnë si pasojë e mungesës së vëmendjes së fjalorëve karshi kësaj klase elementësh. E megjithatë pasthirra gjen përdorim në prozën e shumë shkrimtarëve. Kështu në veprën e Pirandelo's ajo ndihmon për t'i dhënë ekspresivitet prozës së natyrshme dhe spontane të gjuhës italiane të asaj epoke. Në këtë artikull do të paraqesim një studim të pasthirmave që Pirandelo përdor në tregimet e tij dhe mënyrën se si këto pasthirra janë përkthyer në gjuhën shqipe. Do të shikojmë nëse përkthyesit kanë arritur të japin edhe në gjuhën tonë kuptimin e këtyre pasthirmave që herë-herë nuk shërbejnë për të filluar bisedën, por ndikojnë tek kjo e fundit duke nxjerrë në pah ndjeshmërinë e fjalëve të caktuara.

Fjalët çelës: përkthim, pasthirra, ligjëratë, letërsi.

Summary

The study of interjections by grammarians and lexicographers has never been as in-depth as the study of other parts of speech. The hesitation to classify them as a part of speech, on one hand, and the few definitions of them, on the other, have resulted in insufficient knowledge about interjections and the difficulties encountered at times in interpreting them result from a lack of attention to this word class in dictionaries. Nevertheless, interjections are commonplace in many writers' fiction. In Pirandello's works they help lend expressiveness to the natural and spontaneous Italian prose of that epoch. This paper aims at analyzing the interjections that Pirandello uses in his short stories and the way these interjections have been translated into Albanian. We look into whether translators have managed to convey the meaning of the interjections to Albanian language, which more often than not are used to affect a conversation by pointing out the emotional charge that some words carry rather than start a conversation.

Key-words: translation, interjection, speech, literature.